

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

Mbingarkesa kurrikulare
- ndikimi në arritshmërinë dhe
mirëqenien e nxënësve dhe
mësimdhënësve

LIBRI I
ABSTRAKTEVE

Datat e konferencës
1 - 2 dhjetor 2022

Prishtinë, 2022



LIBRI I ABSTRAKTEVE

Nga konferenca ndërkombëtare shkencore
1 dhe 2 dhjetor 2022, Prishtinë

**Mbingarkesa kurrikulare -ndikimi në arritshmërinë dhe
mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve**

Prishtinë, 2022

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin

Nezir Çoçaj, drejtor

Korrektues gjuhësor

Bekim Morina

Përgatitja teknike

Skender Mekolli

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Përbajtja

Këshilli Shkencor	6
Këshilli organizativ.....	6
Rreth konferencës	7
Folësit kryesorë.....	9
Armend Tahirstylaj	
Shkollat dhe kurrikulat mes pritjeve dhe mundësive	9
Osman Buleshkaj	
Zbatimi i kurrikulës: roli i liderishipit	11
Selim Mehmeti	
Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë - Realitet apo perceptim?	14
Majlinda Gjelaj et alt.	
Integrimi i zhvillimit personal dhe i aftësive transversale në lëndët e ndryshme mësimore në kurrikulën e bazuar në kompetenca	16
Merita Shala & Fatbardha Hoxha	
Prioritizim joproportional i fushave të caktuara të kurrikulës në kurriz të të tjerave – rasti i programeve të përgatitjes së edukatoreve parashkollore	18
Majlinda Keta & Gerda Sula	
Mbingarkesa kurrikulare e fëmijës në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar, mirëqenia mendore e fëmijës dhe deficiti në aftësimin si qytetar aktiv në një demokraci funksionale	20

Jasna Rojc & Branko Slivar	
Qasjet për reduktimin e mbingarkesës kurrikulare në zbatimin e reformës kurrikulare në shkollat e mesme në Slloveni	22
Zoran Lalović	
Ndikimi i reduktimit të numrit të mësimeve dhe reduktimit të përbajtjes së teksteve shkollore në cilësinë e mësimdhënies dhe ngarkesën e studentëve	24
Bekim Morina	
Planifikimi i orës mësimore nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta	25
Lirije Bytyqi-Beqiri	
Zbatimi i planifikimit mësimor në arsimin fillor.....	27
Murteza Osdautaj	
Prapambetja në kulturën e leximit dhe efekti i kurrikulave lëndore në arritshmërinë e nxënësve	29
Skender Mekolli	
Praktikat mësimore në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje në shkollën e mesme të lartë	31
Samire Bllaca & Merita Shala	
Mbingarkesa kurrikulare si një ndërthurje e realitetit dhe perceptimit - a vlen kjo edhe për fakultetet që përgatisin mësimdhënësit për arsim fillor?	33
Igballe Krasniqi-Cakaj	
Aspektet e qasjes zhvillimore në mësimdhënien e shkencave natyrore: Sfidat dhe mundësítë në zbatimin e kurrikulës	34
Azemina Kukaj-Kajoshi & Donika Sylejmani	
Aspektet e mbingarkesës kurrikulare në lëndën e biologjisë në arsimin e mesëm të ulët.....	36

Shkëlqesa Osmanaj, Blerta Mehmetaj & Agneta Hasanaj	
Ngarkesa administrative e mësimdhënësve	37
Sevdije Berisha - Krasniqi	
Planifikimi i mësimdhënësve, ngarkesë administrative apo progres në sigurimin e cilësisë	39
Nehat Duraku	
Shqyrtimi analistik i planifikimeve mësimore sipas kurrikulave lëndore të matematikës në klasat 6 dhe 7 – Rast studimi në komunën e Rahovecit	40
Vjollca (Llazani) Ameti	
Sfidat e prindërve përballë ngarkesës kurrikulare të fëmijëve në shkollë.....	42
Teuta Guri	
Roli i drejtorit të shkollës në zbatim të kurrikulës te shkalla e parë dhe e dytë në komunën e Kaçanikut.....	43
Sebahate Sopjani & Arbresha Beka	
Qëndrimet e mësimdhënësve për mbingarkesën e punës administrative dhe sfidat e realizimit të orëve mësimore kreative me nxënësit në klasë	44
Zog Çoçaj	
Aspekte të zbatimit të kurrikulës në rajonin e Hasit: sfidat dhe mundësitet.....	46
Fadil Latifi	
Mundësitet e mësimdhënësve kundrejt të nxënësit të nxënësve: një apo më shumë mësimdhënës në shkallën e dytë të kurrikulës?	47

Këshilli Shkencor

1. Luljeta SHALA - Instituti Pedagogjik i Kosovës!
2. Merita SHALA - Universiteti i Mitrovicës
3. Hatixhe ISMAILI - Universiteti i Prishtinës
4. Naser ZABELI - Universiteti i Prishtinës
5. Linda GRAPCI - Universiteti i Prishtinës
6. Albina PAJO - Universiteti i Korçës
7. Gerda SULA - Universiteti i Tiranës
8. Ismet POTERA - Instituti Pedagogjik i Kosovës
9. Selim MEHMETI - Instituti Pedagogjik i Kosovës
10. Lirije BYTYQI - Instituti Pedagogjik i Kosovës
11. Bekim Morina - Instituti Pedagogjik i Kosovës

Këshilli organizativ

1. Fitore Maliqi - Instituti Pedagogjik i Kosovës
2. Samire Bllaca - Universiteti i Mitrovicës
3. Arbnesha Mexhuani - Instituti Pedagogjik i Kosovës
4. Agim Bujari - Instituti Pedagogjik i Kosovës
5. Skender Mekolli - Instituti Pedagogjik i Kosovës
6. Mevlude Aliu Gashi - Instituti Pedagogjik i Kosovës

Rreth konferencës

Në diskursin aktual të reformave në arsim, ekziston një kërkesë e vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për të mundësuar një ndryshim pozitiv.

Afër një dekadë pas fillimit të reformës kurrikulare dhe pesë vjet nga fillimi i zbatimit në të gjitha shkollat, sfidat dhe ankesat e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, janë të përditshme. Ende ka paqartësi dhe dilema për aspekte të veçanta të përmbajtjes, qasjes dhe zbatimit të KK së re.

Studimet e viteve të fundit, që lidhen me reformën kurrikulare në Kosovë, kryesisht kanë një përqendrim të trajtimit tematik të aspekteve, të lidhura me përgatitjet për zbatimin e kurrikulës, pilotimin e saj, shtrirjen e zbatimit, sfidat në zbatim, etj., pa një fokusim të thelluar në trajtimin e aspekteve të mbingarkesës kurrikulare.

Vendet e OECD-së kanë realizuar një analizë të mbingarkesës në arsim (Curriculum Overload: A Way Forward,, OECD (2020)). Studimi adreson aspekte të mbingarkesës kurrikulare në katër dimensione, të cilat mund të shërbejnë si orientim edhe për kontekste dhe sisteme të tjera arsimore.

Instituti Pedagogjik i Kosovës në bashkëpunim me Universitetin e Mitrovicës organizuan këtë konferencë në mënyrë që të trajtohet mbingarkesës kurrikulare dhe ndikimit të saj në arritshmerinë e nxënësve, në mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve, në aspekte tematike të ndryshme, praktike dhe teorike, ofrimi i evidencave shkencore dhe hapja e debatit profesional dhe shkencor për strategjitë dhe mundësitë e ndikimit në përcaktimin e politikave vijuese për këtë çështje.

Në këtë konferencë ndërkomëtare synojmë që të kuptojmë për së afërmi çështjen e mbingarkesës kurrikulare nga ekspertët e fushave të zbatimit të kurrikulës dhe të refomës, profesor universitar e mësimdhënës shkolle. Një pasqyrë reale për këto aspekte është vlerë e shtuar për vendimmarrësit dhe kahet e zhvillimit të sistemit arsimor.

Në këtë konferencë, Instituti Pedagogjik i Kosovës do prezantoj raportin me rezultatet e studimit: *Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë – (realitet apo perceptim?)*. Studimi i kësaj tematike është një dëshmi e përpjekjeve të Institutit për të mbështetur zhvillimet e reja në arsim, me qëllime të informimit dhe orientimit të politikave e praktikave arsimore.

Studimi vjen në kohën e përbylljes së një faze të reformës kurrikulare, pasi që nga viti shkollor 2021/2022, në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar, punohet me kurrikulat e reja lëndore, të konceptuara në fryshtë e dokumenteve kurrikulare (KKAP dhe KB) të bazuara në kompetenca. Përbyllja e kësaj faze të reformës kurrikulare, shtron nevojën për evidenca, informata kthyese shtesë për të bërë përmirësimet e nevojshme për zbatim të suksesshëm të kërkesave të kurrikulës. Prandaj, IPK-ja, në kuadër të planit të studimeve profesionale dhe shkencore për vitin 2022, projektoi këtë studim të veçantë, çështjen e mbingarkesës kurrikulare, përmes të cilit synoj të hulumtoj çështjet me të rëndësishme që lidhen me ngarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe të ofrojë një informacion tërësor dhe analistik për këtë tematikë studimi.

Nga ky studim dolën gjetje të rëndësishme për këtë tematikë studime, elemente të mbingarkesës kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të rëndësishme, nga dokumentet kurrikulare, por edhe çështje të mbingarkesës së nxitur nga faktori të ndryshëm, të cilat nijhen si mbingarkesë e perceptuar. Krahas pasqyrimit të gjetjeve, studimi ofron edhe rekomandime, orientime për vendosje të një politike arsimore që në thelb duhet të ketë një strategji funksionale për trajtimin dhe preventivën e mbingarkesës së kurrikulës, si dhe kahet zhvillimore për efektivitetin e mësimdhënies, si një nga veprimet kryesore për të garantuar mirëqenien e të gjithë nxënësve dhe eliminimin e pabarazive në mësim.

Rezultatet nga ky studim do ju shërbejë komunitetit arsimor, lexuesve dhe politikëbërësve e studiuesve tjerë të kësaj fushe. Prandaj, është e rëndësissë së veçantë që rezultatet nga studime të tillë të prezantohen dhe diskutohen në konferanca të tillë me pjesëmarrje të gjërë nga komuniteti arsimor. Ne vlerësojmë se me këtë qasje rrisim nivelin e shqyrimit dhe diskutimit shkencor, me përgjegjësi dhe profesionalizëm të çështjeve të rëndësishme arsimore.

Folësit kryesorë

Armend Tahirsylaj

Shkollat dhe kurrikulat mes pritjeve dhe mundësive

Përbledhje

Reformimi i sistemeve arsimore është detyrë që përsëritet e secilit shtet demokratik modern. Në veçanti, reformat kurrikulare detajojnë pritjet dhe aspiratat arsimore, shpesh duke iu referuar dhe si rezultat i ndikimit nga trendët ndërkombëtarë në arsim. Shkollat, si institucione publike, kanë për detyrë që të zbatojnë kurrikulat ashtu që edukimi ta përbushë mandatin e tij shoqëror. Megjithatë, shkollat funksionojnë në mënyra komplekse, larg prej trendëve ndërkombëtarë dhe thellësisht të ngulitura në sfidat vendore e kontekstet politike, shoqërore e kulturore. Përmes shqyrtimit të trendëve ndërkombëtarë në arsim, kryesisht nga perspektiva e OECD-së dhe Bashkimit Evropian, të reformave të fundit kurrikulare në kontekste nacionale, me Kosovën dhe Norvegjinë si shembuj, dhe të përpjekjeve për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca në Kosovë, ky prezantim ofron pikëpamje teorike dhe empirike rreth të kuptuarit të shkollave si vende ku reformat kurrikulare rikonceptualizohen, negociohen dhe kontestohen.

Biografi e shkurtër

Armend Tahirsylaj është profesor i asocuar në Universitetin Norvegjez për Shkencë dhe Teknologji (NTNU) në Norvegji. Ai i përfundoi studimet për PhD në fushën e Teorisë dhe Politikave Arsimore në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë në SHBA, në vitin 2015.

Mësimdhënia dhe hulumtimet aktuale të tij fokusohen në teorinë kurrikulare, traditën e Didaktikës/Bildungut, politikat arsimore, edukimin e mësimdhënësve, vlerësimet ndërkombëtare me shkallë të gjerë, edukimin krahasimtar ndërkombëtar, dhe metodat e hulumtimit. Publikimet e fundit të tij kanë shqyrtuar përgjegjësinë dhe autonominë e mësimdhënësve në traditat arsimore didaktike dhe kurrikulare, përhapjen ndërkombëtare të kurrikulave me bazë në kompetenca, reformat kurrikulare në Kosovë në 20 vitet e fundit, Bildungun në kontekstet e Evropës kontinentale dhe nordike, dhe rolin e politikave arsimore nationale dhe transnacionale në zotërimin e kompetencave kyçë brenda konteksteve nationale. Puna e tij hulumtuese është publikuar në revista udhëheqëse me recension ndërkombëtar, si *Journal of Curriculum Studies*, *Comparative Education*, *Curriculum Inquiry*, *Curriculum Perspectives*, *European Education*, *European Journal of Teacher Education*, *Nordic Studies in Education*, dhe *Nordic Journal of Studies in Educational Policy*. Ai shërben si recensent për një numër revistash arsimore ndërkombëtare, ndërsa në Kosovë është anëtar i Këshillit Kombëtar për Shkencë.

Osman Buleshkaj

Studimes në shkencat e edukimit dhe politikat arsimore

Zbatimi i kurrikulës: roli i lidershipit

Studimet në literaturën profesionale kanë trajtuar rëndësinë e drejtorëve të shkollave për suksesin e një sistemi shkollor dhe të një shkolle individuale. Hulumtuesit theksuan rolin e rëndësishëm që kishte një drejtor shkolle në suksesin e shkollës dhe se si ai/ajo ndikoi në arritjet e nxënësve. Drejtorët e shkollave konsiderohen si udhëheqës të ndryshimeve në organizata që synojnë të krijojnë një kulturë të udhëheqjes së përbashkët dhe kolegiale që angazhon mësuesit të bëhen anëtarë të ekipeve profesionale. Praktikat e udhëheqjes së shkollës po ndryshojnë vazhdimisht dhe po ristrukturohen në mënyrë që pritshmëritë e jashtme, siç është zbatimi i kurrikulës, të mund të përkthehen në praktika të suksesshme drejtuese të shkollës.

Ky studim ishte një përpjekje për të eksploruar zhvillimet e lidershipit arsimor në arsimin kosovar gjatë dy dekadave të fundit, me fokus në praktikën e lidershipit që ndikoi në zbatimin e kurrikulës dhe ndryshimin e politikave në Kosovë. Janë hulumtuar qasjet praktike të përdorura për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së bazuar në shkollë dhe janë identifikuar përpjekjet e udhëheqësve të arsimit në planifikimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollat e Kosovës.

Studime të ndryshme tregojnë se si lidershipi i shpërndarë duhet të lidhet me udhëheqjen për të mësuar dhe bashkëpunimin profesional. Kështu, udhëheqja dhe të mësuarit bëhen komponentë kritikë për përmirësimin e sistemit. Koncepti i udhëheqjes për të mësuar shpjegohet si një rrjet profesionistësh të drejtar nga kërkimi dhe të dhënrat, dhe si një grup kornizash, programesh dhe procesesh të përdorura nga drejtorët e shkollave për të përmirësuar arritjet e nxënësve dhe cilësinë e të nxënëtit.

Modelet e lidershipit që analizojnë rolin e drejtorëve të shkollave kanë potencuar rëndësinë e lidershipit të shpërndarë dhe udhëheqjes së të mësuarit në lidhje me zbatimin e suksesshëm të politikave të reja dhe përmirësimin e shkollës në përgjithësi. Roli në rritje i ekipeve të udhëheqjes me bazë në shkollë, siç janë drejtuesit e departamenteve të kurrikulës, mund të konsiderohet një shembull i shkëlqyer i një praktike të shpërndarë udhëheqjeje që i mundëson stafit të shkollës të mësojë dhe të marrë role udhëheqëse. Prandaj, studimi zbuloi se shkëmbimi i përvojave (vendore dhe ndërkombëtare), mësimi nga njëri-tjetri (shkollat që mësojnë nga shkollat) dhe tejkalimi i sfidave përmes shkëmbimit të burimeve kanë qenë prioritet për udhëheqësit e arsimit që udhëheqin zbatimin e kurrikulës në Kosovë.

Së fundi, gjashtë hapa u identifikuani si veprime të rëndësishme për përmirësimin e praktikës aktuale dhe zhvillimin e lidershipit arsimor në Kosovë për zbatimin e suksesshëm të kurrikulës kombëtare.

Biografi e shkurtër

Është ligjëruar i rregullt në Fakultetin e Shkencave Sociale në Kolegjin AAB dhe ligjëruar i angazhuar në Fakultetin e Edukimit. Ka kryer studimet master i shkencave në fushën e edukimit në Universitetin e Kalgarit, Kanada, ndërsa studimet e doktoratës i kreu në Universitetin ISSBS në Celje, Sloveni, në fushën e shkencave sociale dhe menaxhimin e njohive. Veprimitaria e tij është fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve për udhëheqje

arsimore, politika arsimore dhe menaxhimin e njohurive. Ka qenë anëtar i mekanizmave brenda MASHTI-t (Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues i IPK-së, Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore) dhe është anëtar i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve. Ka qenë bashkëpunëtor profesional e konsulent për mësimdhënien, vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, ngritjen e kapaciteteve për udhëheqjen në arsim, politikat arsimore dhe planifikim strategjik me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, që mbështesin reformat arsimore në Kosovë, në 16 vitet e fundit. Fusha e interesit në punën kërkimore fokusohet në studimin e politikave arsimore, me theks në rolin e udhëheqjes në zhvillimin dhe avancimin e performancës së shkollës.

Selim Mehmeti

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë - Realitet apo perceptim?

Përbledhje

Sisteme të ndryshme arsimore, në përgjigje të kërkesave të shoqërisë për të përshtatur kurrikulën që zbatohet në shkolla me zhvillimet e shpejta shoqërore, teknologjike dhe ekonomike, zgjedhin qasje të ndryshme të rishikimit të kurrikulës. Këto qasje mund të rezultojnë në mbingarkesë kurrikulare, ndikimet e se cilës reflektohen në mirëqenien e nxënësve, mësimdhënësve, dhe në efektivitetin e mësimdhënieς.

Për të gjetur strategji veprimi dhe masa të duhura për të minimizuar ndikimin e mbingarkesës kurrikulare, studimet e literaturës profesionale, që kanë trajtuar këtë problematikë, tregojnë nevojën për eksplorimin e mbingarkesës kurrikulare si një temë të veçantë kërkimi, nga dimensione dhe perspektiva të ndryshme, si dhe nga qasje të ndryshme kërkimi, në varësi të konteksteve të sistemeve arsimore.

Ky studim rasti cilësor shqyrton mbingarkesën kurrikulare në kontekstin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë. Studimi ka për qëllim të eksplorojë nëse përbajtjet e kurrikulave në raport me pritshmëritë dhe kohën mësimore paraqesin ndonjë aspekt të mbingarkesës për nxënës dhe për mësimdhënës, si dhe të përvijojë orientime për adresimin e mbingarkesës kurrikulare, për të siguruar mirëqenien e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe për të mbështetur mësimdhënien efektive.

Për këtë studim u përdorën analiza e përmbajtjes së dokumenteve të kurrikulës në arsimin fillor dhe të mesém të ulët, me një thellim më të veçantë në kurrikulat lëndore. Gjithashtu, janë përdorur intervista gjysmë të strukturuara, pyetësorë e diskutime me fokus-grup, për shqyrtimin e mendimit për mbingarkesën kurrikulare, të atyre që i kanë parë dhe përjetuar mbingarkesën kurrikulare dhe ndikimet e saj (mësimdhënës, nxënës, prindër, drejtues të shkollës, koordinatorë të cilësisë, njohës dhe koordinatorë për zhvillimin e kurrikulave).

Gjetjet tregojnë sa i rëndësishëm ishte një studim rasti i tillë, për kontekstin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Rezultatet e studimit konfirmojnë elemente të mbingarkesës kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesém të ulët, me dallime ndërmjet niveleve të arsimit dhe klasave, të cilat vijnë nga faktorë të shumtë të mbingarkesës. Disa faktorë të pranishëm janë: zgjerimi i kurrikulës, mbingarkesa me përmbajtje dhe pritshmëri të larta për nxënës në raport me kohën mësimore në dispozicion, mbingarkesa e perceptuar nga dokumentet kurrikulare, përdorimi i teksteve shkollore, detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi i nxënësve. Gjithashtu, rezultatet e studimit konfirmojnë ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe në efektivitetin e mësimdhënies.

Rëndësia e studimit është praktike dhe teorike. Rekomandimet e studimet ndihmojnë në vendosje të një politike arsimore që në thelb ka një strategji funksionale për trajtimin dhe preventivën e mbingarkesës së kurrikulës. Kjo qasje mund të gjejë zbatim gjatë rishikimit të kurrikulës, por edhe gjatë udhëheqjes së zbatimit të saj dhe të proceseve të mësimit që ndikojnë dhe kanë nxitur më shumë mbingarkesën e perceptuar. Mirëqenia e nxënësve dhe e mësimdhënësve duhet të jetë referencë parësore në këto procese.

Majlinda Gjelaj¹, Blerta Perolli- Shehu¹, Doris Kuhn², Wiltrud Weidinger Meister², Hana Zylfiu- Haziri³

¹⁾ Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Kosovë; ²⁾ Zurich University of Teacher Education, Switzerland; ³⁾ KEC ³⁾ SHFMU "Isa Boletini"- Rahovec

Integrimi i zhvillimit personal dhe i aftësive transversale në lëndët e ndryshme mësimore në kurrikulën e bazuar në kompetenca

Abstract

Studimi aktual është një dizajn huazi-eksperimental, që eksploron zhvillimin e aftësive jetësore/transversale të fëmijëve nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë, para dhe pas zbatimit të programit të ndërhyrjes për zhvillimin e aftësive jetësore/transversale. Studimi është realizuar në Kosovë, në tri shkolla urbane dhe rurale, të cilat kanë qenë pjesë e programit për zhvillimin e aftësive jetësore dhe zhvillimit personal. Në studim morën pjesë gjithsej 1022 fëmijë dhe 50 mësimdhënës, të cilët zbatuan programin FACE dhe PEACOCK të përgatitura nga Fakulteti i Edukimin në Cyrih të Zvicrës. Vlerësimi i aftësive jetësore u bazua në Shkallën e Vlerësimit të Aftësive të Jetës (LSAS), të zhvilluar në Indi nga Kennedy et al. (2014). Vetë LSAS bazohet në 10 aftësi thelbësore të jetës, të zhvilluara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për vetëperceptimin specifik të fëmijëve, LSAS u përshtat nga Fakulteti i Edukimit të Cyrihut me LSQC – Pjetësori i Aftësive për Jetën për Fëmijë. LSQC dhe LSAS specifikojnë pesë aftësi jetësore që mund të vërehen tek fëmijët dhe të rinjtë: ndërveprimi me të tjerët; tejkalimi i problemeve dhe gjetja e zgjidhjeve; marrjen e iniciativës; menaxhimi i konfliktit; dhe kuptimi dhe ndjekja e udhëzimeve. LSQC është një pyetësor i shkurtër, i përbërë nga 20 deklarata, të cilave fëmijët u japid vlerësimet e tyre (duke treguar vetëvlerësimin e tyre mbi aftësitë specifike të jetës). Mësuesit u udhëzuan përmes një hyrje të shkurtër, se si të administrojnë LSQC në klasat e tyre nga Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, të cilët udhëhoqën gjithë hulumtimin. Përveç shpërndarjes së LSQC

për të gjithë fëmijët në klasë, mësuesit ($N=50$) zgjodhën një mostër të përzgjedhur të fëmijëve për vëzhgim më të afërt. Vëzhgimi është bërë përmes LSAS (Shkallës së Vlerësimit të Aftësive për Jetën) origjinale nga mësuesi i klasës. Mësuesit vëzhguan se cilin fëmijë individual dhe vlerësuan se cilën nga aftësitë në një shkallë 5-pikëshe të tipit Likert. Gjatë gjithë viti shkollor programi i ndërhyrjes u realizua në tri shkollat e përzgjedhura nga të gjithë mësuesit e trajnuar që ndiqnin programin FACE dhe PEACOCK për aftësitë e jetës dhe zhvillimin personal. Për më tepër, studimi hulumtues vlerësoi gjithashtu zhvillimin e aftësive jetësore të vetë mësuesve, duke përdorur një pyetësor në internet për të përcaktuar nëse përdorimi i materialeve të aftësive për jetën në klasën e tyre, gjithashtu, kishte një ndikim në kompetencat e tyre të aftësive jetësore.

Të dhënat e studimit tregojnë se nxënësit nga klasa e tretë deri në të nëntën, të cilët kanë mësuar gjatë një viti shkollor përbajtjen e shkathtësive për jetën përmes lëndëve/kurrikulave të ndryshme, kanë treguar rritje të zhvillimit të tyre në disa nga shkathtësitë e matura të jetës, si: ndërveprimi me të tjerët; tekalimi i problemeve dhe gjetja e zjidhjeve; marrja e iniciativës; menaxhimi i konfliktit; dhe kuptimi dhe ndjekja e udhëzimeve.

Vëzhgimet e mësuesve treguan disa nga pikat e forta dhe të dobëta në lidhje me aftësitë jetësore të nxënësve. Të kuptuarit dhe ndjekja e udhëzimeve duket të jetë aspekti më i mundimshëm për studentët e të gjitha moshave, bazuar në vëzhgimet e mësuesve të tyre, ndërveprimi me të tjerët ishte aftësia më e spikatur e jetës.

Ka dallime domethënëse midis djemve dhe vajzave në lidhje me të pesë aftësitë e jetës, siç vërehen nga mësuesit. Pasi u trajnuan në një program për zhvillimin e mësuesve me bazë në shkollë dhe pasi përdorën materialet e aftësive për jetën, mësuesit besojnë se ata i rritën aftësitë e tyre për jetën, ata gjithashtu do t'ua rekomandonin materialin mësuesve të tjerë dhe gjithashtu identifikuant se u duhesin më shumë trajnime në fushat e përballimit të stresit dhe emocioneve, të menduarit krijues dhe kritik dhe ndërveprimi me të tjerët.

Fjalët çelës: aftësitë transversale, kurrikulë lëndore, integrim, zhvillim personal.

Merita Shala & Fatbardha Hoxha

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë

Prioritizim joproportional i fushave të caktuara të kurrikulës në kurriz të të tjerave – rasti i programeve të përgatitjes së edukatoreve parashkollore

Abstrakt

Mosbalancimi i fushave të caktuara të kurrikulës, prezantohet si një prej dimensioneve të ngarkesës kurrikulare.

Në këtë hulumtim, ne e kemi shtrirë këtë koncept dhe analizën përkatëse në kurrikulën që ofrohet në programet që përgatisin edukatoret parashkollore në Kosovë.

Për të shqyrtuar këtë shpërndarje dhe priroritzim, u analizuan një numër i konsiderueshëm i syllabuseve të lëndëve të programit parashkollar. Syllabuset ishin të prezantuara në ëeb faqet e universiteteve publike të cilat ofrojnë programin e edukimit parashkollar duke qenë institucionet e vetme që bëjnë përgatitjen e edukatoreve parashkollore në Kosovë.

Gjatë analizën u shqyrtua emërtimi dhe përbajtja e temave lëndëve, si dhe formulimet specifike brenda këtyre përbajtjeve. Po ashtu, 163 studentëve të programit parashkollar dhe 10 profesorëve ju drejtua pyetja e hapur se cfarë është ngarkesa kurrikulare dhe si është bërë përcaktimi i fushave të të kurrikulës.

Mbi 78% e përbajtjeve të shqyrtuara, kanë një prioritizim joproportional të fushave të caktuara të kurrikulës në kurriz të fushave të tjera. Dallimi ndërmjet institacioneve universitare ishte mjaft i vogël.

Studentët e shohin kurrikulen e përgatitjes së tyre si të ngarkuar dhe sidomos të keqshpërndarë në përmbajtje apo fusha. Sipas tyre, fokusi është në përmbajtjet teorike të cilat me shumë vështirësi i gjejnë të zbatuara në praktikë. Përmbajtjet që ofrojnë zhvillim të shkakhtësive, janë shumë pak të prezantuara dhe këto përmbajtje studentët i shohin si shumë të rëdësishme. Nga ana tjetër profesorët e perceptojnë përmbajtjen kurrikulare sitë balancuar, dhe 8 prej tyre ju referuan faktit që programi është akredituar si i tillë.

Një diskutim i gjërë dhe i thellë duhet të organizohet në nivel të akterëve që kontribuojnë në përgatitjen e edukatoreve.

Majlinda Keta

Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Gerda Sula

Departamenti i Pedagogji Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranes

Mbingarkesa kurrikulare e fëmijës në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar, mirëqenia mendore e fëmijës dhe deficiti në aftësimin si qytetar aktiv në një demokraci funksionale

Abstrakt

Universitetet mes shumë standardeve përfaqësuese gjatë misionimit të tyre në shoqëri (si prodhimi i intelektualizmit, formimi elitave kombëtare por jo vetëm, projekt ideimi i funksionalitetit të modelit të shoqërisë dhe shtetit në 10, 20 vite më pas etj), kanë dhe duhet të funksionojnë edhe si matës të zoërimit të kompetencave të fituara nga nxënësit nga sistemi arsimor parauniversitar ndërsa në feedback universitetet munden edhe të ideojnë dhe programjnë shkencërisht përmirësimin e cilësisë së tij sikurse dhe politikëbërjen mbi vendimarrjet e saj.

Studimi vijon e njek 5 vitet e fundit (2017-2022) komunitetin e studentëve që fitojnë për studime në filozofi (niveli Bachelor)sikurse ato në masterin shkencor “Mësues i Shkencave Sociale”, pranë Departamentit të Pedagogji Psikologji, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

Teknika e samplit të qëllimshëm është përdorur përfundimisht për të veçuar pjesëmarrësit në studim. Të dhënat janë mbledhur ndërsa janë përdorur intervista me pyetje gjysëm të strukturuara duke i përdorur si burime të para përmirësimi cilësore. Studimi gjithashtu ka analizuar edhe testet e përdorura në Maturën Shtetërore mbi grup lëndët që prodhojnë të dhëna mbi tezën

kërkimore. Studimi pohon mbingarkesën kurrikulare në sistemin parauniversitar (me dallime mes niveleve) por në të njëjtën kohë pohon defiçitin e krijuar mes dijes teorike dhe pjesmarrjes direkte në demokracinë shkolllore, fenomene këto që ndikojnë direkt në mirëqenien mendore të gjeneratave të reja qytetare dhe demokracinë funksionale në vend. Rekomandimet e studimet japid mundësi të rikonceptimit të kurrikulës shkolllore edhe në funksion të reduktimit të mbingarkesës së parauniversitarit dhe jetësimit funksional të demokracisë shkolllore. Këto dy standarde pa dyshim që do të ndikojnë për një mirëqenie mendore shumë më cilësore të gjeneratave të reja sikuse në një aktivizëm qytetar të spikatur prej tyre për një demokraci funksionale.

Fjalë kyçe: fëmijë, nxënës, student, qytetar aktiv, mirëqenie mendore, mbingarkesë kurrikulare, defiçit në demokraci shkolllore.

Jasna Rojc

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Sportit e Republikës së Sllovenisë

Branko Slivar

Instituti Kombëtar i Arsimit i Republikës së Sllovenisë, Lubjanë

Recensentë: dr. Tanja Rupnik Vec, Qendra Andragogjike e Sllovenisë
Saša Kregar, Instituti Kombëtar i Arsimit i Republikës së Sllovenisë, Lubjanë

Qasjet për reduktimin e mbingarkesës kurrikulare në zbatimin e reformës kurrikulare në shkollat e mesme në Slloveni

Abstrakt

Sistemi arsimor slloven përballet me presion nga shoqëria për të zgjeruar kurrikulen duke shtuar lëndët, përbajtjet dhe/ose kompetencat (lexim dixhital, zhvillim i qëndrueshëm, kompetenca qytetare, çështjet e globalizimit, etj.) në kurrikulë. Prandaj, ne kemi filluar me një qasje sistematike për zhvillimin e programit të gjimnazit, qëllimi i të cilit është ruatja e koherencës ekzistuese të kurrikulës dhe parandalimin e zgjerimit të lëndëve dhe përbajtjes/kompetencave, duke pasur parasysh nevojat e shoqërisë moderne. Prandaj, reforma e kurrikulës së gjimnazit bazohet në:

- a) forcimin e integrimit ndërdisiplinor ndërmjet lëndëve nëpërmjet një pakoje tematike ndërdisiplinare (ITP - interdisciplinary thematic package),
- b) prezantimin e një qasjeje aktive dhe autentike ndaj zhvillimit të kompetencave qytetare,

- c) lidhjen e synimeve kryesore të kompetencave/ shkrim-leximin e caktuar me synimet e lëndëve specifike.

ITP është një tërësi koherente, ku realizohen synimet e ndërlidhura nga kurrikulat e lëndëve të ndryshme. ITP bazohet në qasjet moderne didaktike, arritjet komplekse të nxënësve, zhvillimin e kompetencave dhe shkollën si një mjesdit i hapur mësimor.

Kompetencat qytetare zhvillohen brenda seksionit të përbajtjes së pavarur, qytetarisë aktive, bazuar në organizimin dhe zbatimin e ndryshëm të mësimeve. Fokusi është në të mësuarit aktiv dhe në një qasje autentike. Nëpërmjet vendosjes së situatave autentike të të mësuarit dhe dhënies së komenteve cilësore për nxënësit, mësuesi inkurajon rolin e tij/saj aktiv, planifikimin dhe reflektimin mbi të mësuarit.

Qasja e tretë lidh qëllimet kryesore të procesit dhe kompetencat/shkrim-leximin me qëllimet specifike të lëndës. Është thelbësore që qëllimet e këtyre fushave të mos përfshihen në të gjitha lëndët dhe jo në të njëjtën mënyrë, por të arsyetohen në mënyrë të arsyeshme dhe profesionale.

Fjalë çelës: ngarkesë e kurrikulës, kompetencë, qasje ndërdisiplinore, aktive dhe autentike

Zoran Lalović

Byroja për Shërbime të Arsimit, Podgoricë, Mali i Zi

Ndikimi i reduktimit të numrit të mësimëve dhe reduktimit të përmbajtjes së teksteve shkollore në cilësinë e mësimdhënies dhe ngarkesën e studentëve

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që të ekzaminojë efektet e reformës në arsim të zbatuara në Malin e Zi në vitin 2017, duke përdorur shembullin e lëndëve Biologji, Matematikë, dhe Informatikë me Teknologji. Supozimi kryesor i reformës ishtë që reduktimi i numrit të mësimëve dhe reduktimi i përmbajtjes së teksteve shkollarë do të përmirësonte cilësinë e mësimdhënies dhe do të ulte lodhjen dhe ngarkesën punë së studentëve.

Në mënyrë që të testohet ky supozim, janë përdorur rezultatet e hulumtimit empirik të kryera gjatë viteve 2021 dhe 2022 nga Byroja për Shërbime të Arsimit dhe nga Instituti për Tekste Shkollore në Podgoricë. Këto studime kërkimore hetuan efektet e zbatimit të një kurrikule të re dhe përmbajtjes së reduktuar të teksteve shkollore në cilësinë e mësimdhënies dhe në ngarkesën e studentëve. Hulumtimi i paraqitur në këtë punim ka treguar se zvogëlimi i numrit të mësimëve dhe përmbajtjes së kurrikulës si dhe reduktimi i përmbajtjes së teksteve shkollore nuk çon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies ose në uljen e ngarkesës së studentëve. Gjithashtu ka dëshmi se në vend që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies dhe të zvogëlohet ngarkesa e studentëve për shkak të masave të ndërmarrë ka rënje të cilësisë së mësimdhënies dhe rritje të ngarkesës së studentëve.

Ky punim rekomandon një qasje të ndryshme për zgjidhjen e problemit të ngarkesës së punës së studentëve. Në vend që koha e të mësuarit të merret si një barrë për t'u reduktuar, përkundrazi, koha e të mësuarit duhet parë si një mundësi për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe në këtë mënyrë si një mundësi për të reduktuar lodhjen dhe ngarkesën e studentëve.

Fjalët kyçë: ngarkesa e nxënësve, programi mësimor, teksti mësimor, cilësia e mësimdhënies

Bekim Morina

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Planifikimi i orës mësimore nga mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta

Abstrakt

Planifikimi i orës mësimore është pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies, nëpërmjet të cilës mësimdhënësi përcakton qëllimin, rezultatet e të nxënët dhe veprimtaritë mësimore që do të realizohen me nxënës gjatë orës mësimore apo gjatë një njësie mësimore. Kërkesat dhe pritshmëritë e reja të kurrikulës, kërkesat për ndryshim ndaj qasjes së planifikimit mësimor dhe ndaj mësimdhënies shihen si sfida në procesin e planifikimit mësimor. Ky hulumtim shqyrton planifikimin e mësimdhënësve për orë mësimore në dritën e zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Qëllimi i këtij hulumtimit është të analizohen aspektet përbajtjesore të kërkesave të kurrikulës dhe të veprimtarive me nxënës, në planifikimet e orës mësimore që përdoren nga mësimdhënësit e gjimnazeve në Kosovë, si dhe të shqyrtohen opinionet e mësimdhënësve dhe koordinatorëve të cilësisë lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit gjatë planifikimit të orës mësimore. Hulumtimi ka përdorur të dhëna cilësore dhe sasiore, të mbledhura përmes analizës së përbajtjes së modeleve të planifikimeve për orë mësimore, intervistave gjysmë të strukturuara dhe pyetësorëve me mësimdhënës dhe koordinatorë të cilësisë.

Popullacionin e përbëjnë mësimdhënësit dhe koordinatorët cilësisë në shkolla të mesme të larta në Kosovë (gjimnaze), nga i cili është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme mostra e hulumtimit me 58 mësimdhënës të lëndëve e fushave të ndryshme dhe 6 koordinatorë të cilësisë në nivel shkolle. Mostra është përzgjedhur në gjashtë gjimnaze të komunave të ndryshme.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se sfidat, me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit gjatë planifikimit të orës mësimore, janë të shumta, si: planifikimi i rezultateve të të nxënët për orë,

caktimi i kritereve të suksesit, ndërlidhja kurrikulare, vlerësimi i nxënësve, detyrat dhe puna e pavarur, vetëvlerësimi etj. Si pasojë, disa mësimdhënës hezitojnë të përgatisin planin e orës mësimore sipas kërkesave të formularit për planifikim dhe vërehet edhe tendenca për t'i sigruar të gatshme ose për t'i përsëritur planet e orës mësimore.

Për të tejkaluar sfidat, rekomandojmë që t'u ofrohet mësimdhënësve mbështetja e vazhdueshme në planifikimin e orës mësimore, bazuar në të gjeturat nga analiza e planeve dhe monitorimi, si dhe të thjeshtëzohet formulari për planifikimin e orës mësimore ose të hartohet një model i cili tejkalon aspektet teknike dhe vendos në plan të parë elementet e angazhimit kreativ të mësimdhënësve në planifikimin dhe realizim të proceseve mësimore. Gjetjet e hulumtimit do të jenë ndihmesë për mësimdhënësit dhe institucionet arsimore në angazhimet institucionale për të përmirësuar praktikat e planifikimit mësimor në të ardhmen.

Fjalët çelës: kurrikula, planifikim mësimor, model i planifikimit, orës mësimore, mësimdhënie

Zbatimi i planifikimit mësimor në arsimin fillor

Abstrakt

Planifikimi mësimor është proces mjaft kompleks, i cili adreson dhe integron tre komponentë kryesorë: rezultatet, aktivitetet dhe vlerësimin. Hulumtimi është i përzier, sasior dhe cilësor. Qëllimi i studimit ishte të analizojmë lidhjen logjike dhe përmbajtjesore të planeve mësimore, duke filluar nga planifikimi vjetor deri te zbatimi në praktikë i përmbajtjeve të planifikuara në planet mësimore. Për të parë lidhjen e tyre, realizuam studim rasti, përmes të cilit paraqesim të dhëna të rëndësishme lidhur me planet mësimore të hartuara nga mësimdhënësit e arsimit fillor dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Studimi u realizua në 12 shkolla, në të cilat u vëzhguan 26 orë mësimore. Meqë kishte vëzhgim, mostra është e vogël, megjithatë studimi ofron të dhëna të rëndësishme lidhur me mënyrën e planifikimit të mësimdhënësve të arsimit fillor, lidhshmërinë mes përmbajtjeve mësimore të përfshira në planet vjetore, mujore, javore dhe përgatitjeve ditore, harmonizimin mes temave mësimore me njësítë mësimore, aktivitetet e planifikuara me rezultatet mësimore, si dhe zbatimin në praktikë të planifikimit mësimor.

Rezultatet e studimit tregojnë se mësimdhënësit hartojnë plane vjetore, mujore, javore dhe ditore. Planet vjetore dhe mujore i hartojnë në nivel shkolle, ndërsa planet javore dhe ditore i hartojnë vetë mësimdhënësit. Përmbajtjet e përfshira në planet ditore kanë lidhshmëri me përmbajtjet mësimore në planet vjetore dhe mujore. Mësimdhënësit planifikojnë dhe përshkruajnë qartë metodologjinë që do të zhvillohet brenda orës mësimore, por u identifikan mangësi në shtrirjen e rezultateve të të nxënët në planet ditore, lidhjen e tyre me temën dhe rezultatet e temës.

Shumica e mësimdhënësve e realizojnë orën mësimore duke u bazuar në planet ditore të hartuara paraprakisht.

Rekomandimet e studimit adresohen për mësimdhënësit dhe aktorët përgjegjës brenda shkollës lidhur me përgatitjen, analizën, vlerësimin e planeve mësimore e po ashtu edhe monitorimin gjatë realizimit në praktikë të planeve mësimore të hartuara nga mësimdhënësit.

Fjalë çelës: planifikim mësimor, zbatim, arsim fillor, rezultate, nxënës.

Prapambetja në kulturën e leximit dhe efekti i kurrikulave lëndore në arritshmérinë e nxënësve

(Studim analistik mbi ndikimin e përmbajtjeve kurrikulare në arritjen e rezultateve mësimore dhe në zhvillimin e kompetencave të nxënësve në kulturën e leximit (reading literacy))

Abstrakt

Testi PISA, për të gjitha sistemet arsimore që marrin pjesë në testim, paraqet një pasqyrë të përgjithshme të zhvillimit të nxënësve në tri fushat e testimit. Në këtë kuadër, fusha e kulturës së leximit (reading literacy) paraqet fushën kryesore të testimit dhe fushën e cila praqtet bazën e zhvillimit të tërësishëm akademik të nxënësve.

Duke e marrë parasysh faktin se në kulturën e leximit nxënësit tanë kanë shfaqur probleme të jashtëzakonshme, ne e kemi hulumtuar lidhshmérinë ndërmjet kurrikulave dhe rezultateve të treguara në PISA. Për këtë arsy, ky studim kishte për qëllim të konstatojë nivelin e realizimit të përmbajtjeve kurrikulare lëndore, rezultateve të kërkua dhe kompetencave që planifikohen të arrihen nga nxënësit 15-vjeçar dhe nëse të njëjtat janë në funksion të zhvillimit të përgjithshëm akademik të tyre. Gjithashtu, studimi është fokusuar në konstatimin e fakteve nëse kurrikulat lëndore të gjuhës shqipe kanë probleme në realizimin e tyre në shkollë dhe nëse përmbajtjet kurrikulare, për të cilat po flasim, janë në funksion të zhvillimit të kulturës së leximit dhe aftësive të tjera akademike të nxënësve. Të gjitha të gjeturat e studimit, nga literatura dhe nga puna e kryer në terren, janë analizuar bazuar në rezultate e PISA-s në fushën e leximit dhe në gjetjet e projektit të vitit 2021, të realizuar nga IPK-ja dhe të financuar nga MASHT-i.

Hulumtimi ka nxjerrë në pah lidhshmérinë e kurrikulave dhe rezultateve të arritura në PISA në kuptimin e natyrës së përmbajtjeve kurrikulare, realizmit të tyre, arritjes së rezultateve mësimore dhe përfitimit të kompetencave të planifikuara nga nxënësit, duke imponuar nevojën e riaranzhimit funksional të të gjithë faktorëve të përmendur më lart.

Fjalët çelës: kurrikulat lëndore, kultura e leximit, testi PISA, përmbajtjet mësimore, arritshmëria, rezultatet, kompetencat.

Skender Mekolli

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Praktikat mësimore në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje në shkollën e mesme të lartë

Abstrakt

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar. Përmes saj nxënësve u krijojen kushtet dhe mundësítë për të plotësuar më mirë nevojat, prirjet dhe interesat personale në përputhje edhe me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Realizimi i kurrikulës me zgjedhje mbetet kompetencë e shkollës, mirëpo përzgjedhja e lëndëve shpeshherë bëhet jo për nevojat e nxënësve, siç përcaktohet me dokumentet kurrikulare dhe udhëzimin administrativ, por për të plotësuar normën e mësimdhënësve.

Qëllimi i këtij studimi është të analizohen praktikat mësimore të mësimdhënësve dhe drejtoreve në përzgjedhjen e mësimit zgjedhor në shkollën e mesme të lartë si dhe të trajtohen mundësítë dhe sfidat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje.

Instrumentet e përdorura për sigurimin e të dhënave sasiore dhe cilësore janë pyetësori për mësimdhënës dhe intervistat gjysmë të struktura me drejtore të shkollave të arsimit të lartë të 7 regjoneve të Kosovës. Hulumtimi është realizuar në 7 gjimnaze, me 128 mësimdhënës dhe 7 drejtore.

Sipas rezultateve të studimit, pjesa më e madhe e mësimdhënësve në përzgjedhjen e lëndës zgjedhore i përfillin kërkesat e nxënësve dhe vetë shkolla harton programin mësimor sipas kërkesave të nxënësve, kurse disa shkolla e bëjnë këtë nga lista e ofruar prej MASHTI-it. Forma më e shpeshtë e organizimit të mësimit zgjedhor që aplikohet nga

mësimdhënësit është përzgjedhja e lëndës mësimore, kurse organizimi i mësimit zgjedhor me projekte zgjedhore dhe module aplikohet më pak.

Nga rezultatet e hulumtimit rezulton se drejtorët u përbahen në tërësi dokumenteve kurrikulare dhe udhëzimit administrativ në organizimin e mësimit zgjedhor, përfillin kërkesat e nxënësve në përzgjedhjen lëndës zgjedhore dhe mbështesin mësimdhënësit me trajnime përkatëse. Sfidat, me të cilat ballafaqohet shkolla në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje, sipas drejtorëve dhe mësimdhënësve, janë: mungesa e përkrahjes nga institucionet, mungesa e hapësirave të mjaftueshme, mungesa e teksteve adekuate për lëndën, mungesa e mjeteve të punës dhe konkretizimit etj.

Rezultatet e studimit pritet të shërbejnë për hartuesit e politikave dhe mësimdhënësve, duke ofruar rekomandime që lidhen me procesin e organizimit të mësimit zgjedhor, zbatimin e kurrikulës me zgjedhje dhe mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve.

Fjalët çelës: Kurrikula me zgjedhje, zbatimi i kurrikulës, mësimdhënësit, shkolla e mesme e lartë

Samire Bllaca & Merita Shala

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë

Mbingarkesa kurrikulare si një ndërthurje e realitetit dhe perceptimit - a vlen kjo edhe për fakultetet që përgatisin mësimdhënësit për arsim fillor?

Abstract

Koncepti qëndror i mbingarkesë kurrikulare, është shqyrtuar nga shumica e studimeve në nivelin parauniversitar duke e vendosur theksin tek mësimdhënësit dhe nxënësit. Në këtë studim, ne e zgjeruam këtë concept edhe në nivelin e mësimdhënësve universitarë dhe studentëve që janë të përfshirë në programin e përgatitjes së mësimdhënësve fillor. Mbingarkesa e perceptuar i referohet dimensionit të perceptuar ose të përjetuar të mbingarkesës, siç raportohet nga stafi akademik dhe studentët.

Me katër fokus grupe, dy me studentë dhe dy me mësimdhënës, janë zhvilluar disa pyetje që kanë derivuar nga pyetja binare: çfarë është mbingarkesa kurrikulare për ju?

